



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

| | |
|--------------------------------|---|
| Drejtoria | Drejtoria e Urbanizmit |
| Periudha raportuese | Qershori, 2020 |
| Emri dhe mbiemri i reportuesit | Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit |

1. **PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/curisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka vazhduar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për trajtimin e kërkesave të palëve, në kuadër të dy sektorëve:

Sektori i Urbanizmit, ka vazhduar mbajtja e takimeve të rregullta të mëngjesit, me grupet e caktuara të zyrtarëve, ku është diskutuar për raportin favor të punës, si dhe për aktivitetet e planifikuara për javën pasuese.

Po ashtu, është vazhduar me mbajtjen e takimeve të Kolegjiumit (grup i formuar nga zyrtarë të caktuar), për konsultim dhe shqyrtim të kërkesave më specifice, sipas kërkesave të zyrtarëve, si dhe janë caktuar grupe të zyrtarëve të drejtorisë për dhënien e mendimeve profesionale, për çështje që kanë të bëjnë me Sektorin e Urbanizmit.

Takimet me palë janë pezulluar nga data 11.03.2020, me qëllim marrjen e masave parandaluese rreth COVID-19. Komunikimi me palët është kryer nëpërmjet e-maileve dhe telefonit, në raste kur ka qenë e nevojshme palët janë thirrur me ftesë për t'u konsultuar.

Gjatë këtij muaji janë pranuar gjithsej 144 kërkesa të ndryshme. Në këtë periudhë raportuese janë përfunduar gjithsejtë 88 kërkesa.

Zyra e Adresave, po ashtu ka vazhduar punën në kryerjen e aktiviteteve.

Sektori i Legalizimit, procesi i legalizimit ka filluar më 15 korrik 2019, pas miratimit të pesë (5) udhëzimeve administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Me rifillimin e këtij procesi, ky sektor ka pranuar numër të madh të palëve te interesuara për vazhdimin e shqyrtimit të lëndëve, si dhe aplikimime të reja të ndërtimeve pa leje. Bazuar në Ligjin nr. 06/L-024, 2018, procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje do të zgjasë dy (2) vjet, me vazhdim të afatit dy herë radhazi nga një vit.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj .

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Urbanizmit, për muajin vijues, janë:

Sektori i Urbanizmit dhe Zyra e Adresave

- Drejtoria do të vazhdojë punën duke u bazuar në vendimet e qeverisjes qendrore dhe lokale rreth situatës së krijuar nga pandemia botërore, me qëllim të parandalimit të saj;
- Do të vazhdohet me shqyrtimin e lëndëve për caktim të kushteve ndërtimore, për leje ndërtimore, për leje të rrënimit, për certifikatë/leje përdorimi, për dhënien e pëlqimit për bashkim/ndarje të parcelave kadastrale, për dhënien e pëlqimit paraprak shpronësim/kompensim/ këmbim, për miratim të ndryshimeve të projektit kryesor, për korrigjim të akteve juridike, për qasje në dokumente zyrtare, për emërtim të rrugës apo caktim të adresës, për rishqyrtim të lëndëve, për ankesat e ndryshme të palëve e kërkesave tjera, duke zbatuar legjislacionin në fuqi;
- Kolegjumi do të vazhdojë me punën për konsultimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe çështjeve të tjera;
- Janë planifikuar vizita zyrtare në terren për të gjitha kërkesat e paraqitura në vazhdimesi;
- Do të vazhdohet me procesin e dërgimit të kërkesave në KEDS dhe KUR, përmes postës elektronike, për marrjen e pëlqimeve përkatëse për caktimin e kushteve teknike për kyçje në infrastrukturë, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Do të vazhdohet me procesin e dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Do të vazhdohet me zbatimin e orarit të ri të punës në sportelin e kësaj drejtorie, duke ofruar shërbim për palë brenda tërë orarit të punës (sporteli i zhvendosur në katin përdhes të ndërtesës), dhe duke vazhduar me dorëzim-pranimin e akteve juridike dhe shkresave tjera reale aplikuesve dhe, në rast të mosparaqitjes së aplikuesve në sportel, dërgimi i tyre përmes shërbimit postar;
- Do të vazhdohet me procesin e publikimit të vendimeve të kushteve ndërtimore - si fazë e parë e ndërtimit, dhe lejeve ndërtimore, si fazë e dytë e ndërtimit, në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës;
- Do të vazhdohet me regjistrimin dhe publikimin e kërkesave/lëndëve në Sistemiin e vrojtimit të lejeve, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Do të vazhdohet me vendosjen në terren të Njoftimit publik dhe publikimin e këtij njoftimi (paraprakisht, caktimit të Kushteve ndërtimore), në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Do të vazhdohet me publikimin e komenteve të pranuara brenda periudhës së njoftimit publik, bazuar në UA 06/2017:

- Do të vazhdohet me publikimin e përgjigjeve lidhur me komentet e pranuara gjatë periudhës së njoftimit publik, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Urbanizmit, si proces permanent, që ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike, në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital, si dhe përcjellja elektronike e tyre te aplikuesit, te personat fizikë dhe juridikë;
- Sistemimi i projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë;
- Do vazhdohet me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare nga personat e trajnuar për këtë detyrë.

Sektori i Legalizimit

- Do të vazhdohet me rishqyrtimin e lëndëve, plotësimin e dokumentacionit të lëndëve të trajtuara me programet paraprake të legalizimit të ndërtimeve pa leje, dhënien e vërtetimeve dhe me kërkesat e palëve për qasje në aplikacionet e dorëzuara sipas programeve paraprake, ankesat e ndryshme të palëve, e kërkesave të tjera;
- Do të vazhdojmë me pranimin në takim të qytetarëve të interesuar, për t'u konsultuar lidhur me ndryshimin/lehtësimin e procedurave të programeve paraprake dhe Ligjit nr. 06/L-024, 2018, dhe për kërkesa të tjera;
- Janë planifikuar vizita në terren për të gjitha kërkesat e paraqitura në vazhdimësi;
- Do të vazhdohet me mbikëqyrjen e punëve për realizimin e kontratës “Fushatë informimi, vetëdijesimi dhe sensibilizimi për qytetaret e komunës se Prishtinës”;
- Do të vazhdohet me zbatimin e orarit të ri të punës, në sportelin e kësaj drejtorie, duke ofruar shërbim për palë, brenda tërë orarit të punës (sporteli i zhvendosur në katin përdhes të ndërtesës), dhe duke vazhduar me dorëzim/pranimin e akteve juridike dhe shkresave tjera reale, aplikuesve, dhe në rast të mosparaqitjes së aplikuesve në sportel, dërgimi i tyre përmes shërbimit postar;
- Sistemimi i projekteve kryesore në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Në vazhdim janë të listuara aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese, dhe ato në implementim e sipër, si:

Sektori i Urbanizmit dhe Zyra e Adresave

- Konsultimi dhe shqyrtimi i kërkesave, dhe diskutimi dhe vendosja për çështje të tjera të drejtorisë, nga Kolegjiumi;
- Vendosja e njoftimeve publike në terren në të gjitha rastet e kërkesave për kushte ndërtimore;
- Trajtimi i të gjitha komenteve/ankesave të pranuara gjatë periudhës së njoftimit publik;

- Është vazhduar me procesin e dërgimit të kërkesave në KEDS dhe KUR, përmes postës elektronike, për marrjen e pëlqimeve përkatëse për caktimin e kushteve teknike për kyçje në infrastrukturë, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Është vazhduar me procesin e dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Është bërë regjistrimi dhe publikimi i kërkesave/lëndëve në Sistemin e vrojtimit të lejeve, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Urbanizmit, si proces permanent, i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital;
- Sistemimi i projekteve kryesore në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Si të arritura të Drejtorisë së Urbanizmit për këtë periudhë raportuese, vlerësohet të jenë:

- Publikimi i Njoftimit publik, komenteve të pranuara brenda periudhës së “Njoftim Publik”, si dhe përgjigjet lidhur me komentet e pranuara gjatë kësaj periudhe, në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, procedurë kjo e paraparë sipas UA 06/2017, para caktimit të Kushteve ndërtimore;
- Publikimi i vendimeve për caktimin e kushteve ndërtimore, si fazë e parë e ndërtimit, në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës;
- Sistemimi i projekteve kryesore në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Sektori i Legalizimit

- Konsultimi dhe shqyrtimi i kërkesave, diskutimi dhe vendosja për çështje të tjera të drejtorisë;
 - Ka vazhduar trajtimi i lëndëve të dorëzuara me programet paraprake të legalizimit, si dhe lëndëve të vitit 2019 dhe 2020, të ndërtimeve pa leje.
- Sistemimi i projekteve kryesore në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

Si të arritura të Drejtorisë së Urbanizmit-Sektori i Legalizimit, për këtë periudhë raportuese vlerësohet të jenë:

- Ndarja / transferimi i resurseve njerëzore-profesionale, nga drejtoritë dhe sektorët tjera komunalë, për sektorin e legalizimit.
- Pranimi i 89 aplikacioneve të reja për legalizimin e ndërtimeve pa leje, për muajin qershor 2020;
- Sistemimi i projekteve në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR-Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Në Drejtorinë e Urbanizmit janë në vazhdim e sipër aktivitetet ditore, për:

Sektori i Urbanizmit dhe Zyra e Adresave

- Shqyrtimin dhe vendosjen për të gjitha kërkesat e pranuara nga palët e caktuara, duke u përkushtuar në respektimin e afateve ligjore;
- Realizimin e vizitave në terren;
- Vazhdimin e procesit të dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrotje dhe Shpëtim, për marrjen e pëlgjimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
- Vazhdimin e mbikëqyrjes së punëve për realizimin e kontratës “Furnizimi dhe vodosja e tabelave me emra të rrugëve në komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vodosja e numrave të adresave në komunën e Prishtinës”;
- Skanimin e lëndëve të përfunduara dhe sistemimin e tyre në arkivin e drejtorisë;
- Publikimin e vendimeve të lejeve ndërtimore në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Inicimin e procedurës për publikimin e Vendimeve të kushteve ndërtimore, si fazë e parë e ndërtimit, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Regjistrimin e kërkesave/lëndëve në Sistemin e vrojtimit të lëndës, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Vazhdimin e procedurës për publikimin e Njoftimit publik, komenteve të pranuara brenda periudhës së njoftimit publik, si dhe përgjigjet lidhur me komentet e pranuara gjatë kësaj periudhe, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, procedurë kjo e paraparë me UA 06/2017, para caktimit të Kushteve ndërtimore;
- Vazhdimin e procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Urbanizmit, si proces permanent i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital;
- Sistemimin e projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë;
- Inicimi i procedurave për realizimin e investimeve kapitale të buxhetuara këtë vit për drejtorinë;
- Hartimin e projektrregullores për vendosjen e reklamave dhe përfundimin e rregullores për definimin e parametrave urbanë.

Sektori i Legalizimit

- Shqyrtimin dhe vendosjen për të gjitha kërkesat e pranuara nga palët, duke u përkushtuar në respektimin e dorëzimit të aplikacioneve sipas datës se aplikimit, në programet paraprake të Legalizimit;
- Fillimin e procesit të digjitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Legalizimit;
- Sistemimin e projekteve kryesore në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.

4.1.1. STATISTIKAT - Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institacione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuara, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Sektori i Urbanizmit dhe Zyra e Adresave

| Takime me palë | Takime me institucion e/drejtori të tjera | Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare | Kërkesa të pranuara | Të përfundura | Në përfundim e sipër |
|----------------|---|--|---------------------|---------------|----------------------|
| - | - | - | 144 | 78 | 71 |

- Numri i kërkesave të pranuara/kërkesa të reja.....144
- Aktpërcjellës.....7
- Aktvendim.....1
- Ankesë.....4
- Bashkim i parcelave.....0
- Caktim i lokacioneve.....0
- Caktim i pikave.....13
- Kërkesave për zyrën e adresave.....10
- Kërkesa të ndryshme (për ndërtim të ashensorit, për zhvendosje të njehsorëve, për pëlqim për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore, për informata, për koordinata të vijës ndërtimore dhe rregulluese, për shtyrje të afatit, për vazhdim të afatit të vlefshmërisë së vendimit, për emërtim të rrugës, për vendosje të numrit, për njoftim për fillim të punimeve etj.20
- Dërgim materiali.....0
- Kërkesa për koordinata.....0
- Kërkesa për parking.....0
- Kushte, kategoria I.....15
- Kushte, kategoria II.....5
- Leje për rrugë.....2
- Leje, kategoria I.....10
- Leje, kategoria II.....5
- Leje përdorimi.....2
- Leje rrënimis.....2
- Ndërrim destinimi.....1
- Peticion.....1
- Njoftim.....1
- Objekt i përkoshëm.....0
- Parcializim.....0

| | |
|--------------------------------------|---|
| • Plotësim/Ndryshim i projektit..... | 3 |
| • Plotësim/Ndryshim kushte..... | 4 |
| • Plotësim/Ndryshim lejes..... | 3 |
| • Renovim..... | 0 |
| • Riaplikim..... | 0 |
| • Rishqyrtim i lëndës..... | 8 |
| • Vërtetim, dëme lufte..... | 0 |
| • Vendim..... | 0 |
| • Qasje në dokumente zyrtare..... | 0 |

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë trajtuar gjithsejtë 88 kërkesa/lëndë, dhe janë nxjerrë akte juridike dhe shkresat tjera reale, si në vijim:

| | |
|--|----|
| • Aktpërcjellës..... | 6 |
| • Caktim i pikave..... | 8 |
| • Vendim mbi caktimin e kushteve ndërtimore-kat. I..... | 9 |
| • Vendim mbi caktimin e kushteve ndërtimore-kat. II..... | 2 |
| • Vendim për leje ndërtimore-kat. I..... | 13 |
| • Vendim për leje ndërtimore-kat. II..... | 1 |
| • Aktvendim mbi caktimin e taksës administrative dhe tarifës për densitet..... | 18 |
| • Vendim për leje të rrënimit..... | 1 |
| • Aktvendim mbi caktimin e taksës administrative për leje rrënimis..... | 2 |
| • Vendim i lejes së bujqësore..... | 1 |
| • Vendim mbi refuzimin e kërkesës..... | 17 |
| • Vendim mbi pezullimin e procedurës..... | 0 |
| • Vendim mbi përfundimin e procedurës..... | 0 |
| • Vendim mbi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës..... | 1 |
| • Vendim për miratim të ndryshimeve të projektit kryesor/korrigjim të vendimeve..... | 1 |
| • Vendim/pëlqim për lejim të zhvillimit të punimeve..... | 3 |
| • Pëlqim për bashkim/ndarje të parcelave..... | 0 |
| • Njoftime publike për kushte ndërtimore..... | 11 |
| • Informime..... | 9 |
| • Vendosur në lëndën bazë, pas përfundimit me vendim përkatës..... | 2 |
| • Leje për rrugë..... | 0 |
| • Pëlqime | 2 |
| • Plotësime..... | 39 |
| • Inicim konflikti administrativ..... | 0 |
| • Vërtetim..... | 9 |
| • Vendim për emërim komisioni..... | 0 |
| • Plotësim/ndryshim i kushteve | 1 |
| • Plotësim/ndryshim i lejes | 1 |
| • Vendim | 1 |

Sektori i Legalizimit

4 Numri i kérkesave të pranuara/kérkesa të reja gjate muajit qershor.....66

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë trajtuar gjithsejtë 178, si në vijim:

| | |
|---|----|
| 5 Plotësim dokumentacioni..... | 52 |
| 6 Lista e pritjes. | 31 |
| 7 Informim për taksë | 58 |
| 8 Dërgesë dokumentacioni / Dorëzim palës..... | 37 |

8.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të rrënimit, bazuar në Rregulloren mbi taksën administrative për dhënen e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës”, 01 nr. 434/01–0094474/17, dt. 24.04.2017.

Në këtë periudhë raportuese janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **960,554.39€**, nga taksa administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, si dhe nga taksa administrative për leje të rrënimit.

Gjithashtu, janë realizuar 12,392.54 € nga taksa për pajisjen me certifikatë legalizimi.

Gjithsej drejtoria ka realizuar **972,946.93** euro.

8.1.3 Takimet me palë

Drejtoria e Urbanizmit-Sektori i Urbanizmit, ka mbajtur takime të rregullta me palë, deri më 10.03.2020, çdo të martë dhe të enjte, prej orës 9:00 deri në 12:00. Takimet me palë janë pezulluar nga data 11.03.2020, me qëllim marrjen e masave parandaluese rreth COVID-19. Komunikimi me palët është kryer nëpërmjet emaileve dhe telefonit dhe nëpërmjet ftesave për rastet kur ka qenë e nevojshme.

Sektori i Legalizimit

Takimet me palë

Takimet me palë janë pezulluar nga data 11.03.2020, me qëllim marrjen e masave parandaluese rreth COVID-19. Komunikimi me palët është kryer nëpërmjet e-maileve dhe telefonit.

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Nuk ka pasur kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

6. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Sfidë për Drejtorinë e Urbanizmit në të ardhmen mbetet angazhimi i të gjithëve, për respektimin e afatit të përcaktuar ligjor, për përfundimin e kërkesave të palëve, e po ashtu sfidë tjetër mbetet gjetja e metodave për vetëdijesim të qytetarëve që të pajisen me Leje përdorimi/Certifikatë të përdorimit për ndërtuesat që paraprakisht janë pajisur me leje ndërtimi, si dhe për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Synimi i drejtorisë është gjithashtu dhe realizimi me sukses i të gjithë projekteve për investimet kapitale të buxhetuara në kuadër të Drejtorisë.

7. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

Sektori i Urbanizmit dhe Zyra e Adresave

- Të mundësohen trajnime për zyrtarë;
- Të mundësohen vizita zyrtare të stafit, në vendet e rajonit, për të shkëmbyer përvojat e praktikuara në procesin e pajisjes me leje ndërtimore;

Sektori i Legalizimit

- Është siguruar numri i zyrtarëve-profesionist, sfidat që presin ekipin tonë të zyrtarëve janë të mëdha dhe kërkon staf të përgatitur mirë në aspektin profesional;
- Trajnim i stafit sipas konditave dhe standardeve më të reja, të cilat do të aplikohen në përdorimin e programit të caktuar-të avancuar, për aplikim-trajtim të kërkesave në trajtim të ndërtimeve pa leje, në bashkëpunim me MIA dhe programit mbështetës të USAID.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES-Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Urbanizmit, për muajin pasues, janë:

Sektori i Urbanizmit dhe Zyra e Adresave

- Zbatimi i rregullativës ligjore në fuqi, dhe afateve ligjore të përcaktuara, në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për caktim të kushteve ndërtimore, për leje

- ndërtimore, për leje të rrënimit, për certifikatë/leje përdorimi, për dhënien e pëlqimit për bashkim/ndarje të parcelave kadastrale, për dhënien e pëlqimit paraprak shpronësim/kompensim/këmbim, për miratim të ndryshimeve të projektit kryesor, për korrigjim të akteve juridike, për qasje në dokumente zyrtare, për emërtim të rrugës apo caktim të adresës, për rishqyrtim të lëndëve, për ankesat e ndryshme të palëve, e kërkesave tjera;
- Zbatimi i rregullave të vendosura dhe qëndrimeve të marra, në takimet e mbajtura me drejtoritë komunale dhe ministritë përkatëse, lidhur me lehtësimin e procedurave administrative në procesin e pajisjes me leje ndërtimore, si në aspektin eliminimin e procedurave të panevojshme, po ashtu edhe në reduktimin e kohës së nevojshme për përfundimin e atij procesi;
 - Riorganizimi i punës në Zyrën Shërbyese/One Stop Shop, e cila funksionon në kuadër të Sektorit të Urbanizmit, të kësaj drejtorie;
 - Konsultimi dhe shqyrtimi i kërkesave, dhe çështjeve tjera, nga Kolegjiumi;
 - Mbajtja e takimeve me qytetarë të interesuar, për t'u konsultuar lidhur me propozimet për zgjidhje urbane, për dhënien e informatave lidhur me procedurat e aplikimit për caktim të kushteve ndërtimore, leje ndërtimore dhe për kërkesa tjera;
 - Organizimi i takimeve me zyrtarë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për të diskutuar dhe vendosur për lehtësimin e procedurave dhe reduktimin e kohës, në procesin e pajisjes me leje ndërtimore;
 - Realizimi i vizitave në terren;
 - Vazhdimi i procesit të dërgimit të kërkesave në KEDS dhe KUR, përmes postës elektronike, për marrjen e pëlqimeve përkatëse për caktimin e kushteve teknike për kyçje në infrastrukturë, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
 - Vazhdimi i procesit të dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për arritjen e marrëveshjes për infrastrukturë, në mes të kësaj drejtorie dhe pronarit/investitorit, si dhe dërgimit të kërkesave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për marrjen e pëlqimit për masat e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas marrëveshjes së arritur, sipas sistemit “One Stop Shop”;
 - Vazhdimi i mbikëqyrjes së punëve për realizimin e kontratës “Furnizimi dhe vendosja e tabelave me emra të rrugëve në komunën e Prishtinës” dhe “Furnizimi dhe vendosja e numrave të adresave në komunën e Prishtinës”;
 - Përgatitja i njoftimit publik për qytetarë, për publikimin në faqen zyrtare të Komunës, të regjistrit të kërkesave të përfunduara, të cilat janë konsideruar si të braktisura, për shkak të mosinteresimit të palës;
 - Vazhdimi i procedurës për publikimin e njoftimeve publike, paraprakisht caktimit të Kushteve ndërtimore, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
 - Vazhdimin e procedurës për publikimin e komenteve të pranuara brenda periudhës së Njoftimit publik, bazuar në UA 06/2017;
 - Vazhdimin e procedurës për publikimin e përgjigjeve lidhur me komentet e pranuara gjatë periudhës së njoftimit publik, bazuar në UA 06/2017;
 - Publikimi i vendimeve të kushteve ndërtimore, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;

- Publikimi i vendimeve të lejeve ndërtimore, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës;
- Regjistrimi dhe publikimi i kërkesave/lëndëve në Sistemin e vrojtimit të lejeve, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, bazuar në UA 06/2017;
- Vazhdimi i procesit të digitalizimit të dokumentacionit të arkivit/lëndëve të Sektorit të Urbanizmit, si proces permanent i cili ka të bëjë me skanimin e lëndëve fizike, sistemimin e tyre në formë elektronike në hapësirën elektronike të ndarë enkas për arkiv digjital;
- Sistemimi i projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të drejtorisë.
- Inicimi i procedurave për realizimin e investimeve kapitale të buxhetuara këtë vit për drejtorinë;
- Hartimin e projektrregullores për vendosjen e reklamave dhe përfundimin e rregullores për definimin e parametrave urbanë;
- Gjatë muajit mars 2020, Drejtoria ka mbajtur takim me ndërmarrjet: “Termokos” dhe “Val” – Telekomi i Kosovës, për arritjen e marrëveshjes së përbashkët në kuadër të zyrës One-Stop-Shop. Muajt e ardhshëm pritet realizimi i këtyre marrëveshjeve;
- Gjatë muajt mars 2020, është mbajtur takim me “Handikos” në lidhje me zbatimin e normave për personat me aftësi të kufizuara;
- Në vijim, së bashku me USAID, do të mbahet një trajnim lidhur me procesin e legalizimit

Sektori i Legalizimit

- Zbatimi i rregullativës ligjore në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara, në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për ndërtimet pa leje te përfunduara, dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi; Ndërtimet pa leje, të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi; Ndërtimet pa leje, të papërfunduara, të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, dhe Ndërtimet pa leje, te papërfunduara, të kategorisë II te cilat nuk janë shtëpi. Caktim të kushteve ndërtimore për dhënien e Lejes për legalizim përfundim të ndërtimit, e kërkesave tjera;
- Zbatimi i rregullave të vendosura dhe qëndrimeve të marra, në takimet e mbajtura, si në aspektin eliminimit të procedurave të panevojshme, po ashtu edhe në reduktimin e kohës së nevojshme përfundimin e atij procesi;
- Riorganizimi i punës në Zyrën Shërbyese/ One Stop Shop, e cila funksionon në kuadër të Sektorit të Urbanizmit dhe Legalizimit të kësaj drejtorie;
- Mbajtja e takimeve me qytetarë të interesuar, për t'u konsultuar lidhur me propozimet për zgjidhje urbane, për dhënien e informatave lidhur me procedurat e aplikimit për
- Sistemimi i projekteve kryesore, në arkivin e përkohshëm të Drejtorisë.

9. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.